

Sipas dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut Nr.2001/35 të datës 22 Dhjetor 2001 mbi Pensionet në Kosovë,

Me qëllim të ekzekutimit të paragrafit 33 të rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/35,

Bordi Drejtues i Autoritetit Bankar të Pagesave Të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 maj 2002 i ka përshtatur rregullat si vijon:

Rregulla 3 mbi Licensimin Tranzitor të Pensioneve Suplementare Punëdhënëse dhe Pensioneve Suplementare Individuale ekzistuese prej 1 Marsit 2002

Paragrafi 1 Sfera dhe Qëllimi i Rregullës

1.1 Sfera e Rregullës

Kjo rregull i adresohet të gjithë Fondeve të Pensioneve Suplementare Punëdhënëse (në këtë Rregull e referuar si “Fondi i Pensionit”) dhe Pensioneve Individuale Suplementare që ekzistojnë prej 1 Marsit, 2002 dhe dëshirojnë të sjellin rregullimet e tyre për pensione në pajtim dhe në pëlqim me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/35 (“Rregullorja e Pensionit”) dhe Rregullat mbi Pensionet të përshkruara nga BPK në pajtim me Rregulloren e Pensioneve.

Hapi fillestar që të sjellen këto entitete të fondit të pensionit “në pajtim” është licensimi i tyre si Fonde të Pensionit ose Sigurues të Pensionit. Në përpjekje për këtë BPK-ja duhet të ofrojë qdo ndihmë dhe bashkëpunim për të gjitha këto entitete në mënyrë që pjesëmarrësit dhe përfituesit e programeve ekzistuese të pensioneve në Kosovë të arrijnë dhe gëzojnë dobinë dhe mbrojtjen e ofruar sipas rregullores së Pensioneve.

1.2 Qëllimi i Rregullës

Që të rregullohen kërkesat, kushtet dhe procedurat për licensimin e Fondit Suplementar Punëdhënës të Pensioneve dhe Siguruesit të Pensioneve Suplementare Individuale që veq sa janë krijuar, themeluar dhe ekzistojnë prej 1 Marsit, 2002 në pajtim me dispozitat e Kaptinës VII të Rregullores së Pensioneve dhe tu ofrohet atyre qdo mundësi e konformitetit me rregulloren e Pensioneve.

Kjo Rregull zbatohet gjithashtu për “pensionet e paaautorizuara” pavarsisht prej datave që janë krijuar ose themeluar nga Pundhënësi ose nga ndonjë entitet ligjor ose natyral.

Paragrafi 2 **Dispozitat e Përgjithëshme**

2.1 Definimi i kushteve

Te gjitha kushtet e shfytëzuara në këtë Rregull janë ashtu siq janë definuar dhe caktuar në Rregulloren e Pensioneve ose ashtu siq definohe në më pas në këtë Rregull.

“ I licensuari “ është entiteti i licensuar nga BPK sipas kësaj Rregulle duke përfshirë, aty ku aplikohet, drejtorët (trusteve), oficerët, menagjerët dhe nëpunësit e tij.

“Aksionari kryesor” nënkupton aksionarin ose pronarin përfitues të 10% ose më shumë aksioneve të barabarta të Sponzorit të skemës së pensionit dhe /ose entiteti që ka siguruar programe të tilla individuale të pensioneve. Kushtet përfshijnë pronarin kur sponzori është gjysëm pronar, partnerët në rast të partneritetit, anëtarët (ose të quajtur ndryshe), në rast të korporatave që nuk lëshojnë aksione, asociacioneve ose entiteteve tjera të njohura që sponsorojnë Fondin e Pensioneve.

“Sponsor(ë)” nënkupton punëdhënësin(t) , ose ndonjë entitet ligjor ose fizik (natyror) që ka themeluar skemën(at) e pensionit në qdo formë të tij.

“Pensioni i paaautorizuar” i referohet qdo ose të gjithë rregullimeve pensionale, duke përfshirë ato që ekzistojnë në kohën kur Rregullorja e Pensioneve ka hyrë ne fuqi, dhe që janë zhvilluar nga Pundhënësi (Pensioni Suplementar Pundhënës) ose nga ndonjë person legal ose natyral (Pensioni Individual Suplementar) pa Fond Pensional valid ose licensë të Siguruesit të Pensionit të lëshuar nga BPK-ja.

2.2. Determinimi i asaj se Qka e Përbën Pensionin të Mbuluar sipas kësaj Rregulle.

- a. Pensionet e mbuluara sipas kesaj Rregulle. Të gjitha dhe qdo kontratë, marrveshje ose rregullim që premtojnë pagesën ose sigurimin e pagesës me shumë fikse të të hollave në frekuenca mujore ose të rregullta; kur bëhen këto pagesa bëhen, kontraktohen ose premtohen që të paguhen për individin ose përfituesin;

1. Për shkak se:

- a) Ndërprerjes permanente të punsimit me punëdhënësin e veqantë, ose
- b) Kushteve të (kualifikimit) invaliditetit sipas kushteve dhe termeve të kontratës së dhënë ose marrveshjes, ose
- c) Vdekjes së ish puntorit, dhe

2. Për një periodë të pacaktuar të kohës, si psh.:

- a) Për tërë jetën e pensionerit ose përfituesit, ose
 - b) Për një term pa kufizim.
 - c) Periodën e caktuar për 5 vite ose më shumë.
- b. Pagesa për tërë jetën. Pagesa e pensionit mendohet që të bëhet për tërë jetën e pensionerit ose përfituesit dhe një pagesë e tillë ndërprehet kur:
- 1. Me vdekjen e pensionerit ose përfituesit, ose
 - 2. Edhe pas jetgjatsisë së pritur të pensionerit ose përfituesit. Për qëllimin e kësaj Rregulle, jetgjatsia e pritur e një individi është deri në moshën 75 vjeqare.
- c. Pagesa për një afat të pacaktuar. Pagesa e pensionit mendohet të bëhet për një afat të pakufizuar dhe ndërprerja e kësaj pagese bëhet kur:
- 1. E pashprehur për një kohë fikse në të ardhmen, ose
 - 2. Varsisht prej përmbushjes së kushteve që nuk ekzistojnë në kohën kur është bërë kontrata ose marrveshja për të paguar pensionet, ose
 - 3. Subjekt i negociatave të palëve në të ardhmen, ose
 - 4. E padeterminueshme.

2.3 Kushtet e Licensës Tranzitore

- a. Pensionet Punëdhënëse Suplementare dhe Pensionet Individuale Suplementare mundë të sigurohen vetëm nga entitetet ligjore të themeluara në formë të trustit për udhëheqjen e mjeteve të pensioneve.
- b. Dispozitat vazhduese për Pensionet Suplementare Punëdhënëse ose Pensionet Suplementare Individuale mundë të ndërmerren vetëm me licensën e lëshuar në pajtim me Rregullat e licensimit të BPK-s.
- c. Siguruesit e Pensioneve Suplementare Punëdhënëse duhet të licensohen në pajtim me Rregullën 1 të këtyre Rregullave në lidhje me Fondet e Pensioneve.
- d. Siguruesit e Pensioneve Suplementare Individuale duhet të licensohen në pajtim me Rregullën 2 të këtyre Rregullave në lidhje me Siguruesit e Pensioneve.
- e. Taksa e aplikimit/licensës nuk kompensohet nëse refuzohet licensa. Taksa e aplikacionit duhet të paguhet prapë për qdo aplikim të licensimit pasues në rast se lëshimi i licensës të aplikimit paraparak është refuzuar më herët.
- f. Rregulla 1 e këtyre Rregullave përshkruan shumën e taksës së aplikacionit/licensës për Fondet e Pensioneve dhe Rregullën 2 të këtyre Rregullave që cakton taksën e aplikimit/licensës për Siguruesit e Pensioneve.

Paragrafi 3 **Procedura dhe afati kohor**

3.1 Procedura për përshtatje tranzitore me rregulloren e Pensionit.

Duke njohur nevojën për rregullimet ekzistuese të pensioneve që të jenë konform me Rregulloren e Pensioneve në mënyrë që të mundësojnë dobinë dhe mbrojtjen e duhur për pjesëmarrësit e pensioneve dhe përfituesve të tyre, është adaptuar procedura si vijon në lidhje me licensimin e Fondeve të Pensioneve Punëdhënëse ekzistuese dhe Siguruesve të Pensionit:

- a. **Fondet Punëdhënëse të Pensionit.** Siguruesit që kanë ofruar ose ofrojnë aranzhimet ekzistuese të pensioneve të punëdhënësve duhet të aplikojnë për licensë përkatëse duke shfrytëzuar procedurat e licensimit dhe përshtatur me kërkesat e përshkruara në Rregullën 1 të Rregullave mbi Pensionet të lëshuar nga BPK-ja.
- b. **Pensionet Individuale.** Siguruesit që kanë ofruar ose ofrojnë rregullimin ekzistues të pensioneve individuale duhet të aplikojnë për licensë përkatëse duke shfrytëzuar procedurat për licensim dhe pajtuar me kërkesat e përshkruara në Rregullën 2 të Rregullave mbi Pensionet të lëshuar nga BPK-ja.
- c. **Plani i përshtatshmëris.** Sipas kësaj rregulle aplikanti duhet të sjellë në BPK planin ose planet për përshtatshmëri, duke përfshirë caktimin e të Drejtave që nuk Humben të nëpunësve dhe pjesëmarrësve të pensioneve dhe përfituesve të tyre në lidhje me pensionet e premtuara ekzistuese.

3.2 Afati kohor

Duke ditur se në Paragrafin 33.1 të rregullores së Pensionit është përshkruar afati kohor për përshtatshmëri tranzitore të siguruesve ekzistues të rregullimeve të pensioneve, e cila periodë kohore është caktuar për katër (4) muaj prej datës së pranimin të Rregullores së Pensioneve; dhe duke ditur se paragrafi 32.4 tregon se data efektive e rregullores do të jetë 1 Mars, 2002 dhe për këtë ajo periodë për përshtatshmëri prej 4 muajve përfundon më 1 Korrik, 2002; gjithashtu duke ditur, se perioda prej publikimit të kësaj rregulle deri më 1 korrik, 2002 është jo adekuate për siguruesit ekzistuese të rregullimeve të pensioneve që të bien në përputhshmëri me parashkrimin e Paragrafit 33 të Rregullores së Pensioneve dhe Rregullat e BPK-s mbi Pensionet, veqanërisht në qështjen e licensimit, afati kohor është përshkruar si vijon për licensimin tranzitor të siguruesve ekzistues të pensioneve:

- a. **Vendosja në dosje e aplikacionit për licensim (fajlimi).** Aplikacionet dhe dokumentet shoqëruese të aplikacionit të sjellura duhet të vendosen në dosje në BPK para ose më 1 Korrik, 2002.

- b. **Veprimet e BPK-s.** BPK-ja shqyrton aplikacionet gjatë periudhës prej 45 ditësh prej kohës së “vendosjes në fajle”. Para ose më 1 Shtator, 2002, BPK-ja duhet të lëshojë ose refuzojë lëshimin e licensës. Refuzimi për lëshimin e licensës bazohet vetëm në kushtet e paraqitura në Rregullën 1 ose 2 të këtyre Rregullave, përderisa aplikohet. Për aplikacionet e vendosura në dosje para ose më 1 Korrik, 2002, BPK-ja mundet, me lirinë e saj të veprimit, të zgjat afatin kohor jo më gjatë se 30 Shtator, 2002, për lëshimin e licensës, nëse Aplikanti kënaq se plotson ose do të plotsoj kërkesat për licensim dhe planin ose planet për përshtatshmëri të parashtruara nga Aplikanti mundë të kryhen në mënyrë të arsyeshme dhe të ekzekutohen që në mënyrë adekuate ti mbulojnë të drejtat e pjesëmarrësve dhe përfituesve të tyre sipas Rregullores së Pensionit dhe kësaj Rregulle në lidhje me premtimet e tyre për pension.

Paragrafi 4 **Asistenca nga BPK-ja**

- 4.1 Identifikimi i ofruesve të shërbimit.** Dihet se disa kërkesa për licensim kërkojnë shfrytëzimin e ofruesve të shërbimeve financiare ose produkteve që nuk janë lehtë në dispozicion në Kosovë. Me qëllim që të lehtësohet përshtatshmëria me Rregulloren e Pensioneve dhe këto Rregulla, BPK-ja do të asistojë Aplikantët në identifikimin e ofruesve të mundshëm të shërbimeve ose produkteve të tilla.
- 4.2 Plani I përshtatshmëris dhe procedurat .** Aplikanti mundë të kërkojë konferencë me BPK-n që të adresojë qështjet në lidhje me procedurat përkatëse për përshtatshmëri dhe kërkesat që mundë të prezentojnë vështirësitë e përshtatshmëris. Aplikanti parashtron propozimin mbi zgjidhjen e vështirësive. Intenca e Konferencës është që të bëhet plani i përshtatshmëris. Nëse plani i pajtimit është bërë, BPK-ja dhe Aplikanti duhet të zvogëlojnë planin me shkrim, të nënshkruar nga BPK dhe Aplikanti duke rregulluar më herët orarin kohor për përshtatshmërin e Aplikantit.

Paragrafi 5 **Efekti i dështimit për pajtim**

- 5.1 Përfundimi i Rregullimit të Pensionit.** Në rast se nje fondë ekzistues i pensioneve ose sigurues i pensioneve dështon në fajlimin e Aplikacionit të tij, ose ndonjë Aplikant nuk është në gjendje të plotësojë afatin e pajtimit të përshkruar më lartë, pensionet e siguruar nga ata do të përfundojnë në pajtim me Rregulloren e Pensioneve dhe Rregullat tjera të aplikueshme.

Paragrafi 6
Hyrja në fuqi

Kjo Rregull do të hyjë në fuqi me 2 maj 2002.

Drejtori i Përgjithshëm